Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A.
Kosovo Landfill Menagement Company J.S.C
Rr. Sheshi i Lirisë, p.n. Fushë Kosovë 12000, Kosovë
Tel: +383 (0) 38 600 551; 600 552
www.kmdk-ks.org

KMDK.SH.A
KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVË SH.A
KOSOVO LANDFILL MANAGEMENT COMPANY J.S.C
KOMPANIJA ZA UPRAVLJANJE DEPONIJAMA NA KOSOVO DD
Nr. 01-25.11
Dt. 17.01.2025 Shtojce 1
Fushë Kosovë

Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë KMDK Sh.A

Bazuar në nenin 34 të Ligjit Nr. 03/L-087 "Për Ndërmarrjet Publike", nenin 20 të Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087, Ligjin Nr. 06/L-016 "Për Shoqëritë Tregtare" nenit 130, Ligjit 03/L-212 të Punës në Kosovë, Statutit të KMDK Sh.A nenit 7, Kodit të Etikës dhe Qeverisjës Korporative për Ndërmarrjet Publike nenit 26.23, Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Rregullores së Brendshme 01/2024 për Kriteret dhe Procedurat e Punësimit në KMDK, Bordi i Drejtorëve të KMDK Sh.A, në mbledhjen e mbajtur me datën 30.12.2024 miraton Rregulloren si më poshtë:

**Rregullore nr 05/2024 për Ndryshim Plotësimin e Rregullores 23/2020 për Procedurat e Punësimit, Strukturën Organizative dhe Përshkrimin e Vendeve të Punës në KMDK Sh.A**

**Neni 1**

Kapitulli IV, neni 13, sipas kërkesës së donatorit KfW krijohet pozita "Zyrtar Social dhe i Mjedisit", kategoria VI. Kushtet dhe kriteret tjera mbesin të njëjta si në Rregulloren e brendshme 23/2020.

| | |
|---|---|
| **Titulli i pozitës;** | **Zyrtar Social dhe Mjedisor** |
| **Raporton tek;** | **Drejtori i Operativës** |
| **Detyrat dhe Përgjegjësitë;** | • Kryerja e vlerësimeve mjedisore dhe sociale, duke përfshirë Vlerësimet e Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNM), Planet e Menaxhimit Mjedisor dhe Social (PMMS) dhe Planet e Veprimit për Zhvendosje (PVZH).<br>• Siguron përputhjen me ligjet kombëtare, standardet ndërkombëtare dhe politikat e mbrojtjes mjedisore dhe sociale të KMDK-së.<br>• Identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve mjedisore dhe sociale dhe propozimi i masave zbutëse.<br>• Monitoron dhe vlerëson zbatimin e masave mbrojtëse mjedisore dhe sociale gjatë gjithë ciklit jetësor të projektit.<br>• Angazhohet me palët e interesit, duke përfshirë komunitetet e prekura, për të siguruar komunikim transparent dhe mekanizma për zgjidhjen e ankesave. |

| | |
|---|---|
| | mekanizma për zgjidhjen e ankesave.<br>• Siguron ngritjen e kapaciteteve dhe trajnim për stafin dhe partnerët në menaxhimin mjedisor dhe social.<br>• Përgatit raporte periodike mbi performancën mjedisore dhe sociale, duke theksuar arritjet, sfidat dhe rekomandimet.<br>• Mbështet integrimin e praktikave të qëndrueshmërisë në politikat dhe operacionet e organizatës.<br>• Bashkëpunon me ekspertë dhe ekipe të tjera për të siguruar një qasje tërësore ndaj konsideratave mjedisore dhe sociale. I raporton Drejtorit të Operativës. |
| **Kualifikimet dhe përvoja e punës;** | • Diplomë në shkenca mjedisore, shkenca sociale, inxhinieri mjedisore, ose në fusha të ngjashme.<br>• Së paku 3 vjet përvojë profesionale në menaxhimin mjedisor dhe social.<br>• Me orar të shkurtuar, 30 orë në javë. Niveli VI (75% e shumës) |
| **Aftësitë kryesore;** | • Njohja me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të mbrojtjes mjedisore dhe sociale.<br>• Angazhim aktiv me palët e interesit dhe aftësi komunikimi.<br>• Aftësi të demonstruara për të punuar në ekipe multidisiplinare.<br>• Aftësi në gjuhën angleze. |
| **Paga Mujore** | **Niveli VI** |

**Neni 2**

Dispozitat tjera të Rregullores 23/2020 për Procedurat e Punësimit, Strukturën Organizative dhe Përshkrimin e Vendeve të Punës në KMDK Sh.A mbesin në fuqi.

**Neni 3**

Ndryshim -Plotësimi 01/2024 i Rregullores 23/2020 për Procedurat e Punësimit, Strukturën Organizative dhe Përshkrimin e Vendeve të Punës në KMDK Sh.A hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga kryesuesi i BD të KMKD Sh.A.

Afrim Konjufca
Kryesues i BD të KMDK

Fushë Kosovë, 13.01.2024